

UDHËZIM
Nr.5, datë 24.9.2007

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT TË GJUETISË PËR MBARËSHTIMIN E FAUNËS SË EGËR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 8 të ligjit nr.9219, datë 8.4.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7875, datë 23.11.1994 “Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë””,

UDHËZOJ:

I. Të përgjithshme

1. Pjesë të fondit kombëtar të gjuetisë në pronësi të shtetit, u jepen në përdorim personave fizikë e juridikë, vendas apo të huaj, vetëm kur:

a) në to do të zbatohen projekte apo do të ushtrohen veprimtari, që janë në përputhje me qëllimet e përcaktuara në ligj;

b) projektet e veprimtarisë sjellin përmirësime të dukshme në mbarshtimin e faunës që jeton në këto sipërfaqe;

c) projektet e veprimtarisë do të realizojnë investime që përmirësojnë tregues biologjikë dhe të infrastrukturës së zonës;

d) projektet e veprimtarisë janë në harmoni me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me planet e menaxhimit të zonës;

e) projektet e veprimtarisë respektojnë kërkesat dhe elementet e nevojshme për strehim, ushqim, folezim, qetësi etj., të llojeve të faunës së egër që jetojnë në zonë;

f) projektet e veprimtarisë nuk cenojnë vlerat dhe funksionet natyrore e biologjike të zonës.

II. Kërkesa

1. Personi fizik ose juridik, vendas apo i huaj, që synon të marrë në përdorim fondin e gjuetisë për veprimtari për mbarshtimin e faunës, paraqet kërkesën me shkrim në drejtorinë e shërbimit pyjor të rrethit që administron sipërfaqen e kërkuar.

2. Kërkesa përmban:

a) gjeneralitetet e kërkesës dhe të subjektit që ai përfaqëson si emri, adresa e saktë, telefoni etj.;

b) një parashtrim të shkurtër të veprimtarisë që do të ushtrojë;

c) investimet që parashikon të bëjë;

d) kohëzgjatjen e zbatimit të projektit.

3. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë:

a) Fotokopje të noterizuar të vendimit të gjykatës që e ka regjistruar si person fizik apo juridik;

b) Vërtetim që është i regjistruar në organin tatimor;

c) Deklarim personal që i ka mjetet e nevojshme monetare, materiale dhe personelin e kualifikuar për të kryer normalisht veprimtarinë;

d) Një përshkrim të veprimtarive e projekteve që ka realizuar më parë, nëse ka;

e) Projekti teknik që hartohet nga specialistë të licencuar, dhe që trajton të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;

f) Planimetria e sipërfaqes së kërkuar në shkallë 1:10000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore si kufijtë natyralë, konfiguracioni, relievi etj., dhe të paraqiten, dhe pozicioni i objekteve të reja në rast se do të ketë;

g) Dokumente që provojnë se organet e qeverisjes vendore dhe komuniteti përreth, janë dakord me zbatimin e projektit në sipërfaqen e kërkuar.

4. Në mënyrë të veçantë projekti teknik minimalisht trajton:

i) Sigurimin e rritjes dhe mbarshtimin e një ose më shumë llojeve të faunës së egër;

ii) Garantimin e strehimit natyror, ushqimin në natyrë dhe ushtrimit të aktivitetit të gjuetisë sipas ligjeve në fuqi;

iii) Kushtet e jetesës në rast të mbajtjes së faunës në gjendje të mbyllur;

iv) Garantimin e bimësisë natyrore të mjaftueshme në sasi për ushqimin e llojeve të faunës kryesore gjatë gjithë vitit, duke pranuar një ushqim plotësues gjatë një periudhe të caktuar të vitit;

v) Përmbushjen e tre kushteve kryesore: të mbrojtë gjahun nga dëmtuesit, faktorët klimatikë, si dhe të sigurojë kushte për riprodhim;

vi) Programin për vetëmonitorimin e veprimtarisë gjatë zbatimit të projektit;

vii) Planin për përballimin e emergjencave, aksidenteve dhe fatkeqësive natyrore.

5. Aplikuesi mban përgjegjësi për vërtetësinë e dokumentacionit që ka paraqitur. Në qoftë se edhe një dokument i vetëm rezulton jo i vërtetë, kërkesa nuk shqyrtohet, leja nuk miratohet ose anulohet e hiqet po qe se është dhënë.

III. Shqyrtimi i kërkesës

1. Drejtoria e Shërbimit Pyjor (DSHP) e rrethit përkatës, merr në dorëzim dhe regjistron dosjen e paraqitur. Në rastet kur dosja nuk është e plotë, ajo ia kthen kërkuarit për plotësim. Koha për plotësimin e dosjes nga kërkuari nuk llogaritet në afatet procedurale, të cilat fillojnë nga dita e pranimit dhe regjistrimit të dosjes.

2. DSHP-ja e shqyrton dosjen, harton raportin e saj teknik në përputhje me kërkesën dhe zonën ku do të zbatohet projekti dhe shpreh me shkrim mendimin e saj zyrtar për projektin.

3. DSHP-ja e përcjell dosjen për shqyrtim në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të saj.

4. Në ministri dosja shqyrtohet nga një komision i posaçëm, që kryesohet nga drejtori përgjegjës për çështjet e faunës. Në përbërje të komisionit marrin pjesë specialistë të sektorit të faunës, të burimeve pyjore dhe të sektorit të legjislacionit. Mendimi i sugjerohet ministrit, i cili në rast miratimi, aprovon lejen sipas modelit bashkëngjitur.

5. Ministria e shqyrton kërkesën brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të dosjes nga DSHP-ja dhe njofton me shkrim subjektin për vendimin e marrë.

6. Tarifa e shqyrtimit dhe miratimit të lejes paguhet paraprakisht dhe është e pakthyeshme.

7. Kundër vendimit, kërkuari mund të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit.

8. Kërkuari vihet në dijeni për miratimin e lejes. Leja i jepet atij pasi ka shlyer qiranë vjetore të përdorimit për sipërfaqen që i është akorduar. Për vitet pasardhëse kjo tarifë paguhet në fillim të vitit kalendarik dhe jo më vonë se data 30 janar. Nëse nuk paguhet tarifa brenda këtij afati, Policia Pyjore bllokoi kryerjen e veprimtarisë për këtë vit.

9. Udhëzimi nr.3, datë 7.6.2006 “Për dhënien në përdorim të fondit të gjuetisë për mbarështimin e faunës së egër”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Politikave të Mbrojtjes së Natyrës
Sektori i Faunës

Rruga "Durrësit" nr.27, Tiranë, Tel.270624 Fax. 270 627

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____

Vendimi nr. _____

LEJE E INTEGRUAR

**PËR
DHËNIE NË PËRDORIM
TË PJESËVE TË FONDIT TË GJUE TISË**

Në mbështetje të nenit 8 të ligjit nr.9219, datë 8.4.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7875, datë 23.11.1994 "Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë" dhe të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit",

Subjektit ".....", me përfaqësues Z. _____, me qendër në _____, i jepet leja,

Për marrje në përdorim të fondit të gjuetisë në rrethin _____,

Për zbatimin e projektit:

Vendndodhja:

Sipërfaqja: _____ ha

Sipas kërkesës dhe të dhënave të dosjes i jepet leja e marrjes në përdorim, me kushtin që të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

- Të rriten një ose më shumë lloje për mbarështim dhe objekt gjuetie;
- Të garantohet mundësia për strehim natyror, ushqim natyror dhe ushtrim të gjuetisë;
- Të sigurojë vazhdimësinë me bimësi të pasur me lloje të mjaftueshme në sasi për të garantuar ushqimin e llojeve kryesore gjatë gjithë vitit, duke pranuar një ushqim plotësues gjatë një periudhe të caktuar të vitit;
- Të mbrojë gjahun nga dëmtuesit, nga kushtet klimaterike, si dhe të sigurojë kushte për riprodhim;
- Të kryhet monitorimi periodik dhe informacioni të dërgohet në DSHP-në e rrethit çdo vit.
- Të marrë masa për ruajtjen në tërësi të objektit nga veprimet e kundërligjshme që shkaktojnë dëmtim të florës dhe faunës së egër.

Të zbatohet me përpikmëri:

- Ligji nr.7875, datë 23.11.2004 "Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë", i ndryshuar;
- Ligji nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.449, datë 26.6.2003 "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.236, datë 21.4.2005 "Për disa ndryshime e shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.449, datë 26.6.2003 "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve

dhe kullotave”;

- Rregullorja nr.1, datë 23.2.2005 “Për mbarështimin, mbrojtjen e faunës së egër dhe zhvillimin e gjuetisë”.

Kjo leje është e vlefshme për një periudhë _____ vjeçare, me të drejtë përtëritjeje.

Mosfillimi i aktivitetit brenda një periudhe njëvjeçare sjell për pasojë pavlefshmërinë e lejes për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Shfaqja e elementeve të reja ekologjike të panjohura, në kohën që kjo leje është dhënë, bën rivlerësimin ose heqjen e lejes.

Për mosrespektimin e kërkesave të legjislacionit përkatës dhe të kushteve të lejes, ka sanksione ligjore.

Mbështetur në udhëzimin nr.1, datë 23.11.2005 “Për tarifat e shërbimit për lejet mjedisore”, leja e mësipërme klasifikohet në pikën _____, germa _____.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli